

POETRY 84
Poezia Nr 84

Në dritë gjysmëhëne

Në fije floku zu fill dashuria
Se falltoret nuk e lexonin dot hieroglifin në sy
I tundte krahun feniksi shqiponjës
Se kush e ndjente stinën vallë?!
Anipse qe vjeshtë
Çuditërisht...një zë i ri erdhi në jetë!
O toka o ora u rrotulluan përnjëherësh
Gjykimi të premtën e shenjtë u caktua
ooo betohem n`kokën tënde e timen
Se gjysmëhëna dëshmitarja e "çmendurisë" sonë ishte.
N`dry e pata ruajtur buzën për shekuj të tërë...
(pyet natën po deshe).
Do bëj gjumë pa ëndërra sonte
Amanet, kur t'bie terri i verbër ma puth Konteshën
ANTE i botës sime!